



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-28185 dt. 21/07/ 2025

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z.Bekim Lestrani, më datë: 30.07.2025 (e mërkure) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të këtë


Rend dite:

1. Procesverbalin e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i mbajtur më datën 30.06.2025;
2. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Auditimit dhe pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Drenasit për vitin 2024;
3. Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes Lokale Janar-Qershor 2025;
4. Raporti Financiar Janar-Qershor 2025;
5. Të ndryshme.

Drenas, 21.07.2025



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Bekim Lestrani



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-27937 dt. 18/07/ 2025

PROCESVERBAL

I mbledhjes së pestë të rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 30.06.2025, e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani dhe deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani (PDK), Labinot Halilaj (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri - Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Kosovare Halilaj- Karaxha (PDK), Sali Dvorani (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Egzona Terdevci (VV), Filloreta Bujupi (VV), Selman Qallapeku, Arbër Halilaj (GREEN), Egzon Qorri (LDK), Muhamet Kurtaj, Mirlinda Dvorani, Florentina Elezi-Veliu.(VV).

Munguan: Beqir Kiqina (AAK), Qendrim Mulaj(PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Arben Shala nënkryetar i Komunës së Drenasit dhe drejtorë të drejtorive, si dhe përfaqësuesit e OSBE-së.

Mbledhja do të ketë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal i mbajtur më 29.05.2025;
2. Vendim për plotësim- ndryshim të Vendimit nr. 02.020/04-19803, të dt. 29.05.2025 të komisionit për plotësimin - ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba;

3. Draft Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028;
4. Informim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë 2025;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi prezantoi rendin e ditës, e hodhi në votim rendin e ditës, prezent ishin 26 anëtarë të Kuvendit, rendi i ditës kaloi me 26 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën.

1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, të dt.

29.05.2025. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës, e cila kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 2.Vendim për plotësim - ndryshim të Vendimit nr. 02.020/04-19803, të dt. 29.05.2025 të komisionit për plotësim - ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, me qenëse anëtari që ka kërkuar me u liruar nga ky komision është nga PDK-ja, ftojë përfaqësuesin e PDK-së që të propozoi një anëtar të ri, fjala për Kosovaren.

Kosoavre Karaxha, nga grupi i PDK-së, propozojmë Gani Krasnqin.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani me propozimin e ri bëhët plotësim-ndryshim i anëtarit të komisionit për plotësim - ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba. Edhe një herë po ju a prezantoj anëtarët e këtij komisioni:

1. **Fluida Nika** - kryetare nga ekzekutivi;
2. **Shehrije Mustafa** - anëtare nga ekzekutivi;
3. **Lumnije Prenku** - anëtare nga ekzekutivi;
4. **Gani Krasniqi** - anëtar nga Kuvendi;
5. **Mërgim Pirraku** - anëtar nga Kuvendi;
6. **Egzona Tërdevci** - anëtare nga Kuvendi;
7. **Arben Kuliqi** - përfaqësues nga Shoqëria Civile, anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës e cila kaloi me 26 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesues i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 3.Draft Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028.

Egzona Terdevci, i kam disa pyetje dhe disa komenete lidhur me Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028, fillimisht të pjesa tekstuale tek forcimi i ekonomisë është përmend mbështetja direkte e Sektorit të bujqësisë, cili është lloji i mbështetjes që është planifikuar për bujqit jashtë atyre që jepen nga Ministria e Bujqësisë. Në faqen 8 stafi për arsimin parafillor është i njëjtë, janë 36 punonjës të planifikuar në këta 36 punonjës a janë llogarit edhe punonjësit për çerdhet e reja për të cilat veq i keni ndarë parcelat në janar të vitit 2024.

Tek lista e projekteve kapitale tek rreshti i katërt emërtimi i projektit është vërtet Drenas, nuk e kam të qartë për çfarë projekti bëhet fjalë, për kënd kanë me u blerë 100 mijë euro vetura zyrtare në vitin 2026. Korniza Afatmesme Buxhetore fatkëqësisht ka qenë vazhdimisht përsëritja e projekteve të njëjta që shpesh parë gjatë tërë mandatit mundesh me e pa në Kornizë Afatmesme Buxhetore që i vetmi projekt i ri të infrastruktura është rregullimi i trotuareve dhe ndriçimi publik në Drenas, Komoran, Arllat, Terstenik, Dobroshec dhe Baicë, 1.4 milion euro për tri vite i nderuar z. Lladrovci unë kam qenë po thuajse në të gjitha dëgjimet publike dhe kërkesa më e madhe prej fshatrave është trotuari, a mendon që vërtet ky buxhet i përmnbush kërkesat për trotuar dhe a ka mundësi me u ndryshu për me pasë më shumë, sidomos në vendet ku rrezikohen fëmijët duke shkuar në shkollë.

Tek rinia, kultura dhe sporti janë planifikua 35 mijë euro për tri vite për fusha sportive, ku kanë me u ndërtua këto fusha sportive, sepse nuk e keni cek vendin pastaj varësisht ku e shihni me të nevojshme në bazë të votave tek rinia, kultura dhe sporti po ashtu janë paraparë 9 mijë euro për blerjen e librave, për cilat shkolla kanë me u blerë këto libra.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, po provoj me të dhënë përgjigje për pyetjet që i di. Ky ka qenë dëgjimi i parë buxhetorë ne e kemi edhe dëgjimin e radhës e pastaj i kemi edhe takimet që i bëjnë asambleistët me qytetarë vijnë ndryshimet dhe bëhen në fund të mbledhjes së Kuvendit me 30 shtator, nëse nuk gaboj. Folët për stafin e ri për çerdhet, staf unë nuk mundem me shtu, sepse Qeveria e Kosovës e përcakton numrin e punëtorëve në bazë të numrit të banorëve, jo që nuk mundem me e shtu, por kam frikë që kanë me na ndeshku me zvoglu numrin për shkak se ne nuk e kemi mbërri nurmin e duhur të banorëve karshi numrit që e kemi të stafit të punëtorëve.

Projektet investive ne i mbledhim në një projekt për me i zhvillu procedurat më lehtë, 100 mijë euro vetura për dijenin tëndë dhe të krejt qytetarëve që na dëgjojnë, këto mjete besoj janë për Komunën. Ju e dini në çfarë gjendje i kemi makinat e Komunës dhe sa pak makina kemi, asnjëherë nuk kemi marrë me qira dhe nuk kemi blerë sene të shtrenjta dhe nuk ka kryetar në Kosovë që e ka ruajtur buxhtin më shumë se unë.

Sa i përket rrugëve, trotuareve dhe ndriçimit me dhjetra herë edhe në dëgjime buxhetore edhe në takime me qytetarë kam thënë që trotuaret i shtroj çdo kund ku kam hapësirë publike, prona është bërë e shtrenjtë sidomos kur të bëjmë mjete me i shpronësu pronat e rrugëve publike për trotuarë edhe këto kemi me i bërë njëherë nuk kemi mundësi, ndriçimin po besoj e bëjmë këtë vit po kodi është trotuarë, ndriçim çka do që ka nevojë aty shkon.

Sa i përket fushave sportive besoj që do të bëhen në Korroticë të Epërme, Arllat, Komoran, nuk janë përfundimtare asnjë ku do që janë të nevojshme investimet për qytetarët e Drenasit do t'i bëjm.

Egzona Terdevci, atëhere për projektin që është emërtuar veq në Drenas nuk u sqarua mirë nëse e përcjell Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe buxhetin për katër vite radhazi duhet me qenë fjala për projektin e parkut pishat në Gllobar, i cili nuk ka përfunduar ende me e përcjell renditjen e projekteve po duhet me u ndreq se nuk mundet me shku, po besoj që është dasht me qenë pak më të kujdesshëm këtu përgjigjet të tjera ishin të mangëta. Po mëqenëse ka ende degjime buxhetore, kemi me diskutu edhe në shtator së nuk pate informata konkrete e kemi përmend edhe në degjimet tjera buxhetore dhe kur është diskutu korniza buxhetor nuk është në rregull kur po i përmendni asfaltin në Gllobar, asfaltin në Terstenik që në shtator me ardh me të qarta.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e tretë të rendit të ditës e cila kaloi me 23 vota për, 3 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 4. Informim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë 2025. Pasi nuk pati diskutime vazhdojmë me pikën e pestë .

Egzona Terdevci, i kam dy pyetje për drejtorin e Infrastruktues e para është për një kanalizim në Polluzhe për të cilin është bërë kërkesa ne vitin 2023. Në përgjigjen e Komunës të dt. 29.09.2023 ju drejtor keni thënë që, brenda ndarjeve buxhetore, brenda vitit 2023-2024 keni me e shqyrtuar mundësinë për këtë investim, por jemi në qershor 2025 dhe ende nuk keni bërë asgjë bëhet fjalë për 400 metra kanalizim për me u kyçë në kanalizimin kryesor të fashtit Polluzhë, parashtruesi i kërkesës është Agim Istogu. Pyetja e dyta ka të bëjë me rrugën Hysni Bilalli Shtrubullovi kanë mbet 100 metra pa u shtru ma kanë adresuar si shqetësim nëse mundemi me e ditë pse ka mbet.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nuk i ka dy javë që kemi pas degjim publik për investimet e vitit 2025 janar –qershor dhe i kemi dhënë të gjitha përgjigjet përgjegjësve të lokaliteteve edhe qytetarëve të cilët kanë pas ineters me ardhur. Në Kuvend ne bëjmë raport, e kemi obligim ligjor po me vjen mirë që kan mbet edhe rrugët, si Hysni Bilalli për ka 100-50-20 metra pa i shtruar.

Drejtori i Infrastrukturës Endrit Gllareva, sa i përket kanalizimit në fshatin Polluzhë, sigurisht që ka me u përfundu gjatë këtij viti. Sa i përket rrugës ne Shtrubullovi nuk e di që ka rrugë publike pa u përfundu, është një por ajo është në kontest gjygjësor po besoj që do të zhgjidhet shpejt ai problem.

Mehdin Salihu, unë i kam disa pyetje për drejtorin e arsimit dhe për drejtoreshen e Shëndetësisë. Drejtor së pari të uroj për përfundimin e vitit shkollor, shkollat janë në gjendje shumë të keqe sidomos aty ku është numri shumë i madh i nxënësve p.sh.shkolla Rasim Kiqina, porosia ime është që në të ardhmen mos mendoni vetëm për ngrohjen e shkollave, sepse tani klima ka ndrru mendoni edhe për klimatizimin e

shkollave dhe nuk është shumë i kushtueshem.

Të përgëzoj për punën drejtoreshë edhe për marrjen e autoambulancës me qenëse ky vit është i mirënjohjeve është dashtë me e falenderu edhe personin adekuat që ka kontribu zni. Arianja, shefja e departamentit për vizita shtepijake. Po më interson me ditë a ke informata, pse janë ndërprerë punimete e QKMF-së së re, edhe në këtë mandat tëndin drejtoreshë vazhdojnë punëtorët të drejtat e veta që ua garanton ligji edhe kontaratat me i nxjerrë vëtëm përmes përmbaruesit dhe përmes gjykatës nuk është në rregull por edhe ju kushton juve.

Nuk jeni duke bërë program të mirë në planifikimin e punës p.sh që dy tri vjet janë dalë 6 punëtoe në penzion edhe ju nuk keni marrë punëtor të ri në shumë vende tjera me qenë aktive edhe me qenë me një program në punë është dashur me hap konkursin në momentin që del në pension puntori. Unë kam marrë pushim pa pagesë që dy vjet dhe t'i nuk e ke marr askend në vendin tim, t'i punon me të njejtin staf si ke fluks si ke gjendje stabile unë nuk e di që ke staf të mjaftueshem, t'i nëse ke e tërhjeki fjalën.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, të nderuar një zyrtar i QKMF-së, siç është Mehdin Salihu thotë që dy vjet jam në pushim pa pagesë. Drejtoreshë ligji ja mundëson një zyrtari vëtëm një vit pushim pa pagesë të lutem t'i ndërmerrni të gjitha masat adekuat ligjit. Ju folet për autoambulancë, ka dy- tri vjet që ne bëjmë kërkesë dhe kësaj here na ka ardhur radha vitin e kaluar është dashtë me na dhënë Qeveria, por për dijenin e juaj dhe të qytetarëve tri ose katër autoambulanca i kam sjellë donacion nga qytetarët tonë në Europë, pse nuk po zhvillohen punime në QKMF, është çështje e Ministrisë e cila është duke i shqyrtuar disa të meta të projektit.

Po i pres proceduart e Ministrisë, pastaj unë i procedoj ku duhet me i procedu të gjitha imellat i kemi, sepse unë komunikoj shumë me imella.

Sa i përket temperaturave të larata dhe zhvillimit të mësimi ligji e thotë deri në çfarë temperature mundemi me mbajt mësim edhe kur mundemi me i lëshu në pushim, mirë që i kemi kry të gjitha ato që duhet me i kry për shkolla po besoj që në të ardhmen do të bëjmë edhe klimatizimin edhe për ftohje edhe për ngrohje kur ka ndonjë ditë të ftoftë para aftateve dimrorë.

Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies SocilaeLumnije Krapi, Ariana është një punëtoe shumë e zellëshme dhe e vyeshme, por nuk ka të bëjë me kërkesën për veturë emergjente, sepse kjo i përket një sektori tjetër, programi që e zhvillon Ariana është 0-3 vjet program që shkojnë nëpër shtëpi për gra shtatzëna d.m.th para dhe pas lindjes. Sa i përket pyetjes për pagesat e punëtorëve shëndetësorë, kjo është e nënshkruar me kontratë kolektive nga Ministria edhe ne jemi duke ju përmbajtur asaj kontrate ashtu siç ju takon me ligj, jo pse duhet me i aprovu ne, ndërsa lidhur me mungesën e punëtorëve nuk kemi mungesë të punëtorëve sipas Udhëzimit Administrativ 04/2020 deri në 1500-2000 banorë e kemi një mjek, dy infermiere d.m.th stafin e kemi të kompletuar.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, grantin për staf shëndetësorë e kemi të përcaktun me ligj dhe numrin e përcaktun me ligj nën 50 mijë banorë kemi numër me të vogël, pra ne nuk mund të rekrutojmë staf në rast se kemi më shumë staf mas atij

numrit të stafit që na takon me 48 mijë banorë dhe nuk na e lejon sistemi me rekrutu staf të ri, ne kemi staf më shumë, sepse ne punojmë në dy qendra 24 orë e që spunon kërkush në Kosovë dhe në QKMF, pra ne bëjmë shpënzime më shumë se që kemi grant të përcaktum me kuotën që e përcakton niveli qëndror në kuadër të Ministrisë së Financave. Tani është duke u bërë sistemimi i qytetarëve për të mjeku familjar dhe tani e shohim edhe këtë në sistem në të ardhmen.

Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Socilae Lumnije Krapë, granti specifik i shëndetësisë aprovohet prej Ministrisë së Shëndetësisë dhe implementohet prej Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, asnjë stafë rekrutues nuk merret pa Udhëzimin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale .

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, në aspektin infrastrukturor qëndrojmë shumë mirë ku jemi ndër pak komuna që i kemi të kompletuara shkollat me teknologji informative dhe me kabinete të teknologjisë informative, janë të paisuara me tabela të menqura pra ne punojmë në bazë të prioritetëve sepse këto kanë qënë prioritet tona dhe i kemi përfundur, tani mbetet edhe paisja e shkollave me klima.

Mehdin Salihu, tha se cila shkollë është e pajisur me klim përveç të drejtori që është klima e vendosur.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, shkollat janë të paisura po nuk janë në secilën kalsë.

Azmine Gjoka, tha se kam një kërkesë që e kam bërë për asfaltimin e rrugës “Shaban Polluzha në fashtin Terstenik”, kjo kërkesë është bërë edhe me hërët në vitin 2024 keni premtu së në vitin 2025 keni me e realizu e nuk është realizu. Mua nuk më është kthyer asnjë përgjigje që e kam bërë edhe një kërkesë tjetër për të njejeten rrugë 100 metra të rruga “Shaban Polluzha në fashtin Terstenik”.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, rruga Shaban Polluzha është ku lidhet udhëkryqi që e ndanë rrugën për Çikatove e deri të kufiri me Skenderajn, është pronë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe nuk është e jona ka dhjetra vite që po kërkoj me u përfundu rruga prej Komoranit e deri në Skenderaj, nese është ndonjë rrugicë që e kemi e nuk është Shaban Polluzha, jemi në proces ju e dini që përmbaruesi na ka marrë një milion e gjysëm mjete në kode investive dhe kemi mbet pa i zhvillu disa projektet për atë qëllim nuk është faji i jonë por i kontartave kolektive.

Azmine Gjoka, njëra është 100 metra është rrugicë d.m.th përfaqesuesit e lagjës Dvorani, këta e kanë bërë edhe një kërkesë me nr.15.070-01-45370, dt.13.09.2024 unë edhe një kërkesë tjetër e kam bërë por nuk me është kthyer asnjë përgjigjeje.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, kërkesat mund të vijn edhe në pronë private nuk e di a është pronë privatë 100 metra a është pronë publike po në pronë publike besoi që mbyllet si proces në pronë privatë unë nuk guxoi ju e dini që deri në 28 mijë euro na ka

kushtu një ari të Kukiqt jo në qeverisjen time por ne e kemi pagu, nesë është publike besoi që e kryjm.

Azemine Gjoka, një kërkesë e kam bërë të lagja Bujupi afër IP-së, janë disa shtëpi aty kanë probleme me një kanalizim që është hapë disa hërë po nuk është bërë zgjidhja e përgjithshme, kam bërë edhe një kërkesë për me bërë zgjidhje me afat gjatë për arsye së po shkakton probleme dua me e ditë a keni me realizu dhe kur keni me e realizu.

Drejtori i Infrastruktures Endrit Gllareva, sa i përket kanalizimit në lagjen Bujupi në Arllat, unë jam në kominikim të vazhduëshem me banoret dhe ju kam premtuar që gjatë korrikut do të jem aty dhe kemi me i zgjedh të gjitha këto probleme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi nuk pati pyetje as diskutime tjera të pika të ndryshme e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Më gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit, të dt. 30.60.2025 mund ta ndiqni në ueb faqen zyrtare të Komunës, në rrjetin social.
<https://ëëë.facebook.com/share/v/16yR6AmGyD/>

Mbledhja përfundoi në ora 11:10.

Procesmbajtësja



Fakte Hoti

Lekturoi



Nikelinda Bujupi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Bekim Lestrani



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01 Nr 40001-25419 dt. 04/07/ 2025

PËR: z. Arianit Bala, Kordinator

NGA: Grupi punues për zbatimin e rekomandimeve të Zyres Kombëtare të Auditimit për vitin 2024.

Lënda: Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të "Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Drenasit (Glllogocit) për vitin 2024"

1. Liridona Durmishi, Kryesuese; _____

2. Ksamil Ramadani, Anëtar; _____

3. Gentiana Qela, Anëtar; _____

4. Shaban Dobra, Anëtar; _____

5. Shehrie Mustafa, Anëtar; _____



Në pajtim me nenin 14 të Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, si dhe duke u mbështetur në Procedurat Standarde të Trajtimit të Rekomandimeve të Zyres Kombëtare të Auditimit, po ju dërgojmë Planin e veprimit për zbatimin e Rekomandimeve që dalin nga "**Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Drenasit për vitin 2024**"

PLANI I VEPRIMIT

PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE NGA RAPORTIT TË AUDITIMIT TË PASQYRAVE VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2024

Cështja	E gjetura	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrur	Zyrtari/ët përgjegjës	Afati I implementimi
Çështja B1-Keq klasifikim i shpenzimeve	Nenit 18, paragrafi 3 e Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë Janë vërejtur keq klasifikime të shpenzimeve nper kategori ekonomike ne vlere 2,488.200€.Nga Kjo vlere thesari kishte paguara sipas urdherva përbarimor per zbatimin e kontrates kolektive bga kategoria e investimeve kapitale 1,879,133€ dhe sherbimeve Komunale 27,849€ Pagesat për paga jubilare dhe shuqita kanë ndodhur si rezultat i	Kryetari duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet qe shpenzime te planifikohen ne ndarjet adekuate te bushtetit(apo te ridentinohen mjetet kur eshte e nevojshme dhe e mundeshme)dh e qe pagesa e regjistrimi I shpenzimeve behet sipas kodeve ekonomike	Do të vazhdojme te kërkojme dhe insistojme tek niveli qendror qe te gjejne zgjidhje, shtim të masës buxhetore për këtë kategori të shpenzimeve nga Ministria e Financave, meqense shpenzimet që kanë dal nga kontratat kolektive-sektoriale, me qarkore buxhetore nuk mund të buxhetohet.	ZKA dhe ZKF	I pamatshëm

Çështja A1 - Nënvlërësim i i pasurive nën 1,000€	kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk kanë mundur të planifikohen me buxhet. Rregullorja MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.1. përcakton se, "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu neni 6.3. përcakton se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Në regjistrin e pasurive jo financiare nën 1,000€, kemi vërejtur pasuri të blera në vitin 2023 dhe 2024 për 117 njësi për tabela të mençura me vlerë 112,203€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e-pasuria që rezultojnë në nënvlerësimin e regjistrit të pasurive jokapitale. Kjo ka ndodhur si rezultat i kontroleve të dobëta në	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Janë regjistruar në sistemin e-pasuria dhe pranuar në regjistrin kontabel në e-pasuri.	Zyrtari i E-pasurisë, zyrtari i pasurisë	I Implementuar 2025
--	--	--	---	---	----------------------------

monitorimin dhe verifikimin e regjistrave të pasurisë	monitorimin dhe verifikimin e regjistrave të pasurisë	Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen afatet ligjore për lëshimin e lejeve ndërtimore, duke forcuar kontrollin e brendshëm dhe mbikëqyrjen mbi trajtimin e kërkesave, në mënyrë që të mundësohet mbledhja me kohë e të hyrave	Komuna do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që të respektohen afatet ligjore në mënyrë që mos të ketë vonesa në lëshimin e lejeve të ndërtimit.	Zyrtarët nga drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe nga kompania e KEDS-it, Ujësjiellësi Rajonal Sh.A.”Prishtina”, zyrtarët nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent dhe zyrtarët nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës,	2025
Çështja A2-Vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore. Nenit 17(pika 1.2)I Ligjit të Ndërtimi thotë;”Leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent Brenda 30 ditëve pas pranimit te kërkeses per leje ndertimore per kategorine I dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategorin e II dhe III. Në dy (2) raste ka vones ne lëshimin e vendimeve per lejet ndertimore sipas afatit limgjor nga ana e Komunes pas pranimit te kërkeses per leje ndertimore. Vlera totale e ketyre mosttrave eshte 100,610€,kurse vonesat ne lëshimin e lejeve ndertimore jane deri 220 ditë. Kjo ka ndoshur për arsye të mosfunksionimit efektiv të kontrolleve të brendshme dhe vonesat në pëlqimin nga KEDS-I për kompletimin me kohë të dokumentacionit.	Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen afatet ligjore për lëshimin e lejeve ndërtimore, duke forcuar kontrollin e brendshëm dhe mbikëqyrjen mbi trajtimin e kërkesave, në mënyrë që të mundësohet mbledhja me kohë e të hyrave	Komuna do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që të respektohen afatet ligjore në mënyrë që mos të ketë vonesa në lëshimin e lejeve të ndërtimit. Nëse nuk sillen me kohë dokumentacionet e nevojshme për marrjen e lejes së ndërtimit si : -Pëlqimi për rregullim të dokumentacionit teknik nga kompania e KEDS-it, -Pëlqim për kushte teknike nga Kompania Ujësjiellësi Rajonal Sh.A.”Prishtina” , -Pëlqim në dokumentacionin investivo-teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent,	Zyrtarët nga drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe nga kompania e KEDS-it, Ujësjiellësi Rajonal Sh.A.”Prishtina”, zyrtarët nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent dhe zyrtarët nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës,	2025	

Cështja A3 – Shpërblimi më kontratë në mungesë të plotësimit të kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit			-Pëlqim për kyqje në rrugë Nacionale (Magjistrale), Regionale dhe Autoudhë, nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, Zyrtarët nga DUMM do të detyrohen të kryejnë procedurat për refuzim të lëndës sipas ligjeve në fuqi.		
	Ligji i prokurimit publik Neni 59 paragrafi 4 parasheh: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, rregullorja 001/2022 për prokurimin publik neni 28.7 parasheh: Afati i fundit për dorëzimin e sigurimit të tenderit do të jetë i njëjti si ai për dorëzimin e tenderëve. Sigurimet e tenderëve të pranuar pas afatit për dorëzimin e tenderit do të refuzohet dhe	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat	Zyra e Prokurimit do të ketë kujdes të shtuar në monitimin dhe vlersimin e procedurave të prokurimit .	Zyra e Prokurimit	I Mënjehershëm

	kështu do të rezultojë në refuzimin e tenderit. OE te shpërblyer me kontrate ne mungese te plotesimit te kerkesave te njoftimit per Kontrate dhe dosje te tenderit po i parqesimi rastet si ne vijim • Te kontrate per “Ndertimin ,zgjerimin dhe rikonstruimin i rrugeve te asfaltuara ne Drenas-projekt dy vjeqar(Rruges tre -Kater korsi(Rikonstruimi)Rrug a Fehmi dhe Xheve Lladrovci),ne vlere te tenderit ne kerkesen per pershtatshmeria profesionale pika 6 jane kerkuar raportet e auditimit per tri vitet e fundit 2023,2022 dhe 2021 ndersa operatori ekonomik ne oferten e tij ka paraqitur raportet e rishikimit te pasqyrave financiare vjetore; dhe • Te kontrate per “Ndertimi i aneksit te SHFMU Rilindja”ne Dobreshec ne vlere te	ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë ne procesin e vlerësimit të ofertave përkatëse dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.		
--	---	--	--	--

	kontraktuar 26,978€, operatori ekonomik fitues ne oferten e tij nuk ka dorezuar sigurin e tenderit Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së funksionimit të kontrolleve të brendshme, në fushën e prokurimit.				
Çështja A4 – Realizimi i artikujve të kontratës me çmim për njësi, jo në përputhje me peshën e përcaktuar në dosje të tenderit dhe pranimi i shërbimeve të paarsyetuar a	Bazuar në nenin 54.15 të Rregullores 001/2022 dhe interpretimit te KRPP- së të datës 09.06.2023 parasheh: “Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë për qind (30%), në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar”. Duke pasur parasysh faktin se peshimi	Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i kontratës nga menaxheri i kontratës bëhet në pajtim me kërkesat ligjore, në mënyrë që kontrata publike kornizë me çmim për njësi të realizohet në pajtueshmëri të plotë me peshën e përcaktuar në dosjen e tenderit dhe pranimi, pagesa e shërbimeve të	Komuna do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që menaxhimi i kontratave të bëhet në pajtim me kërkesat ligjore për kontratën publike kornizë me çmimin për njësi dhe të realizohet në pajtueshmëri me peshën e përcaktuar në dosjen e tenderit.	Menaxhëret e kontratës	2025

	i artikujve duhet bërë duke u bazuar në peshën dhe në rëndësinë e çdo artikulli , kjo nënkupton që vlera dhe sasia e realizuar (shpenzuar) e artikujve nuk mund të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë fillimisht në dosjen e tenderit dhe Rregulloja 01/2013/MF- Për shpenzimin e parashë publike, Neni 24, paragrafi 1.2 parasheh: të siguroj raportin e pranimi të mallit/shërbimit nga zyrtari / komisioni i autorizuar. Kontrata publike kornizë me cmim njëjës”Nëshitetje profesionale me komponentin e mirëgenies sociale dhe shërbimit publik për qytetaret e komunës së Drenasit”kornizë trevjeqare me cime për njësi për artikull e nënshkruar me datë 16.08.2022,ku në të parashihej për artikuj ne vijim: • Artikulli(pozicioni)3”shërbime administrative në koordinim e punës në fushë e e ekonomisë dhe financave ,raporteve ,dokumentimin ,menagjiorimin si dhe evidentimin e shërbimve të kryera sipas standarteve specifike etj”e peshuar me 5% në vitin 2024 bazuar në situacione/fatura të pranuarra/ekzekutuara ishin realizuar shërbime në vlerën 95,985€që ka rezultuar në tejkalim në vlerë 36,763€ dhe artikulli(pozicioni)7”shërbime në kordinimin e	bëhet sipas shërbimeve reale të ndodhura.		
--	---	---	--	--

				punë:raporteve mujore.dokumentimin ,menagjimit si dhe në evidentimin e shërbime të kryera sipas standardeve specifike,duke kontrolluara dhe monitoruar stafin etj”e e peshuar me 5%,ndërsa ishin pranuar/ekzekutuara sherbime ne vlerë 148,797€ qe ka rezultuar në tejkalim në vlerë 89,875€ Poashtu në testimin per artikullin (poziciopni)7”sherbime ne koordinimin e punës:raporteve mujore,dokumentimit,menagji mit si dhe ne evidentimin e sherbimeve të kryera sipas standardeve specifike,duke kontrolluar dhe monitoruar stafin etj,që nënkupton shërbimi për raportet mujore të përgatitur nga të angashuarit e kompanisë për kryerjen e shërbimeve të kontraktuara,ku në mbështetje të listave të pagave mujore për vitin 20224 për kryerjen e sherbimeve ndaj komunësnga të angazharit e kompanisë është 596 paga mujore,që rezulton në ofrimin e shërbimit në vitin 2024 janë bërëfaturime-pagesë/situacione për këtë shërbim në vitin 2024 janë bërë në vlerë 148,797€ e që rezulton në mbi faturim/pagesë/pranim të situacioneve ne vlerë 132,705€ të paarsyetuara (fiktivee). Tejkalimi dhe pranimi sherbimeve të paarsyetuara	
--	--	--	--	---	--

	ka ndosur si rezultat i mbikëqyrjes së dobët nga na ae menaxherit të Kontratës.				
Çështja B2 – Mungesa e projekteve ekzekutuese	Paragrafi 19.17 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik ndër tjerash parasheh se ”Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t’i bashkëngjitet (githashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit”. Në shtatë(7) raste komuna kishte filluar proceduar e prokurimit dhe kishe lidhur kontrata pa hartuara projekt ekzekutiv dhe atom ishin si ne vijim: - Projekti për Ndërtimi i aneksit të SHFMU Rilindja” në Dobroshec me vlerë të kontraktuar 26,975€. - Projekti për Asfaltimi i rrugëve në fshatin Sankoc,Fushicë e Epërme dhe e Ulët “Ilot II me	Kryetari të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Do të hartohen projektet për të gjitha projektet të cilat cilat kanë një kosto të lartë financiar ka zhvilluar procedura për hartim të projekteve. Ndërsa ato te cilat janë në vlera të vogla janë vetëm me params dhe parallogari.	Të gjitha Drejtoritë që kanë projekte kapitale.	I menjëhershëm

	• Projekti për "Asfaltimi i rrugëve Komoran I,II,III dhe IV lioti I me vlerë të kontraktuar 111,222€. • Projekti për "Asfaltimi i rrugëve dhe Kubëzimi Drenas I,II,III dhe IV" lioti III me vlerë të kontraktuar 173,280€. • Projekti për "Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Nekoc dhe Kishnarek" me vlerë të kontraktuar 139,702€. • Projekti për "Regullimi i trotuarit dhe ndriçimit publik-Drenas Komoran Arllat Terstenik Dobroshec dhe Baicë" me vlerë të kont.221,970€ dhe, Projekti për "Ndertimi,Zgjerimi dhe rikonstruimi i rrugëve te asfaltuara ne Drenas" me velere te kont.269,945€. Kjo ka ndodhur si rezultat I mungesës së planifikimit të duhur para fillimit të procedurave të prokurimit,duke përfshirë mungesën e hartimit të projektit ekzekutiv për projektet specifike.				
--	--	--	--	--	--

Çështja A5 – Mos raportim i rregullt për shfrytëzim të pronave komunale	Neni 22 paragrafi 2 i Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përcakton se “Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore t’i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim”. Kryetari i Komunës nuk kishte paraqitur asnjë raport periodik gjashtëmujor Kuvendit Komunal lidhur më monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme. Shkak i ndodhjes është mosrespektimi i kërkesave ligjore në lidhje me raportimin dhe mbikëqyrjen e kontratave për shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.	Kryetari duhet të sigurojë se raportet rregullta gjashtë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.	Zyra e Kryetarit do të formoj një komision për raportim të rregullt për shfrytëzim të pronave publike.	Zyra e Kryetarit-Komisioni për raportim për shfrytëzim të të pronave publike	2025
---	--	--	---	---	-------------

Çështja B3 – Mangësi në databazën e tatimit në pronë	Ligjin nr. 08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme neni 3 dhe Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11 pika 1 definojnë:” Zbritja për vendbanimin parësor- Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklararon këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohej zbritja prej 30,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Po ashtu, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë ka njoftuar komunat për vendimin e marr për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, kjo me qëllim të shmangies së duplikimeve/apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni. Nga analiza e bazës së të dhënave për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se 148 persona kishin përftuar zbritje të tatimit në pronë pa numër personal.	Kryetari duhet të marrë veprime shtesë për të siguruar se janë bërë korrigjimet e nevojshme në bazën e të dhënave të tatimit në pronë, në mënyrë që zbritja për vendbanim parësor të bëhet vetëm për personat fizik të cilët janë të regjistruar me numër personal dhe kanë deklaruar në komunë se objekti shërben si vendbanim parësor.	Jemi duke punuar dhe jemi duke përmirësuar të zbritja e 30,000.00€ në vlerë dhe nga ky muaj nuk ndodh që tatim paguesi i regjistruar ta ketë të hequr banimin primar pa e validuar nr. e identifikimit. Poashtu edhe oër tatim me vlerën 0 kam derguar një email për ti hequr nga sistemi. Ne kemi vazhduar me plotësimin e regjistrave me nr. personal duke kerkuar nga zyra e gjendjes civile me aq mundësi sa ata po na ofrojnë sepse ka probleme të ndryshme ka persona që nuk janë në regjistra, ka persona të vdekur e që figurojnë të ngarkuar me tatim, vetëm nga nëntori 2024 e deri tani janë regjistruar në sistem diku 762 numra personal	Zyra e Tatimit në Pronë	2025
--	---	---	--	--------------------------------	-------------

	Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në departamentin e tatimit në pronë.				
--	--	--	--	--	--

Cështja B4 – Monitorimi i menaxhimit të kontratave jo përmes E- Prokurimit	Paragrafi 70,24.f. i Rregullores nr.01/2022 për Prokurimin Publik parashihet se “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistemin e prokurimit elektronik”. Menaxheret e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes sistemit elektronik të prokurimit publik. Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Komuna e Drenasit ka përpiluar listën për trajnimin e menaxherëve të kontratave dhe ju është drejtuar lkap.	Zyra e Personelit	2025
--	--	---	--	--------------------------	-------------

Çështja A6 – Mangësi në procesin e inventarizimit t dhe vlerësimit të pasurive jo financiare Gjetja	Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 19.4.3 përcakton se: “Çdo fundvit bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare, tutje neni 21 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare”, po ashtu neni 11.3 përcakton se: “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet dhe zhvlerësimi”. Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk kishte bërë krahasimin(harmonizimin)e gjendjes së inventarizuar me gjendjen e pasurive në regjistrat kontabël, rrjedhimisht nuk dihet diferenca në mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Poashtu nga raportet e vlerësimit të pasurive jo financiare kanë rezultuar në pasuri jo financiare jashtë përdorimit dhe	Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat, si dhe zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo	Komuna do të ndërmarrë të gjitha masat që bëhen harmonizimi I gjendjes së inventarizuar me gjendjen e pasurive në regjistrat kontabel.	Komisionet e formuara për inventarizim dhe Vlerësim , Zyrtari i Pasurisë	2025
---	--	--	---	---	-------------

	të dëmtuara, si pasojë që akoma nuk ishte formuar komisioni për vlerësimin e pasurive që do të rezultonte në përgatitjen e raportit për pasuritë që duhet të largohen nga përdorimi dhe në përditësimin e regjistrave kontabël. Gjithashtu duhet të theksojmë se nga analiza e shpalosjes dhe të dhënave të pasurive jo financiare kapitale mbi 1,000€ në PFV kemi vërejtur se skoma ka të regjistruara në kategorinë investime në vijim për vitet 2014 deri në vitin 2023 në vlerë totale 4,616,410€ të cilat përkundër që mund të jenë në përdorim akoma mbahen në regjistrat si pasuri në vijim. Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme lidhur me zbatimin e kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare.	financiare kapitale sipas klasifikimit kontabël			
--	--	---	--	--	--

Çështja A7 – Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme	Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbarese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këllë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në inkasimin e llogarive të arkëtueshme, duke mos përjashtuar edhe masat juridike.	Janë derguar 280 vërejtje të tatimpagueseve si e vetmja mundësi për inkasim sa me të lart, pastaj me takime të ndryshme për t'i bindur qytetarët që pagesa e tatimit në prone është në favor të qytetarëve dhe ndikon në mirëqenien e tyre dhe në investime kapitale. Jemi duke punuar me intensitet të shtuar por pasi janë hequr kushtëzimet me nxjerrjen e dokumenteve ka rënë edhe niveli i pagesave. Nga viti I ardhshëm është planifikuar që tatimpahuesve mbi 200€ t'i dergojmë me letërkujtesa , njoftimi përfundimtar, bllokimi i llogarive si dhe vendim për ekzekutimi të tatimpaguesve që nuk i ka kryer obligimet tatimore.	Zyra tatimit në prone	Në vazhdimësi
Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në inkasimin e Llogarive të Arkëtueshme (LIA) pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite.	(10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.				

	Për mostrat tona nuk kemi vërejt që komuna ka marr ndonjë veprim konkret për vitin 2024 për inkasimin e LIA. Pjesëmarrjen më të madhe e kanë të arketueshmet ishte nga tatimi në pronë 2,036,025€, taksat për ushtrimin e veprimtarisë 1,795,263€, shfrytëzimi i dhënies së pronës publike (qiraja) 888,348€ dhe të tjerat 19,590€. Dobësitë e identifikuara lidhur me llogaritë e arketueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin përkatësisht inkasimin e tyre.		Është ndërmarrë veprim konkret lidhur me zvoglimin e llogarive të arketueshme- taksat për ushtrimin e veprimtarisë me vendimin 02Nr.431/01 - 47980 te dt.30.09.2024 janë falur borxhet e bizneseve nga viti 2000 deri në vitin 2019. Sa i përket inkasimit të detyruar për vitet 2022, 2023 dhe 2024 nuk kemi mundur të inicojm procedurë përbarimore pasi ligji 04/L-139 ka pësuar ndryshime ku aktet administrative (vendimet-aktvendimet) nuk përbarohen lidhur me këtë kemi ndërmarr veprime për ndryshimin e rregullores komunale per taksa, tarifa,ngarkesa dhe gjoba..	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik,Komisjoni për plotsim ndryshimin e rregullores komunale për taksa, tarifa,ngarkesa dhe gjoba.	Në vazhdimësi
--	---	--	---	--	---------------